

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR MASAT SHTRËNGUESE NDËRKOMBËTARE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektligji është vendosja dhe zbatimi i masave shtrënguese ndërkombëtare në funksion të ruajtjes së paqes dhe sigurisë, parandalimit të konflikteve ndërkombëtare, mbështetjes dhe forcimit të demokracisë, sundimit të ligjit, të të drejtave të njeriut, si dhe arritja e objektivave të tjerë të sigurisë së përbashkët, në përputhje me rezolutat përkatëse të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, akteve të organizatave të tjera ndërkombëtare apo marrëveshjeve ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë.

Përveç përmbushjes së qëllimit për ruajtjen e paqes e të sigurisë, ky projektligj ka si objektiv edhe përmbushjen e detyrimeve që vendi ynë ka si vend anëtar i Kombeve të Bashkuara për zbatimin e rezolutave të OKB-së, që dalin në zbatim të kreut VII (Veprime në rast të rrezikimit të paqes, të prishjes së paqes dhe të kryerjes së një akti agresioni) të Kartës së Kombeve të Bashkuara, si dhe rekomandimet e Task-Forcës për Veprim Financiar (TFVF) që kanë rishikuar standardet ndërkombëtare sa i përket luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Konkretisht, përmendim rekomandimin 6 mbi “Sanksionet specifike financiare të lidhura me terrorizmin dhe financimin e tij” dhe rekomandimin 7, mbi “Sanksionet specifike financiare të lidhura me përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë”. Në këtë frymë vijnë edhe rekomandimet e Komitetit MONEYVAL (organizëm monitorues i Këshillit të Evropës nën varësinë direkte të Komitetit të Këshillit të Ministrave të Këshillit të Evropës), i cili është organizëm monitorues i Këshillit të Evropës nën varësinë e Komitetit të Këshillit të Ministrave të Këshillit të Evropës, apo detyrimi për zbatimin e masave shtrënguese të BE-së në vijim të politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë (CFSP), në kuadër kjo edhe të aspiratës për anëtarësim në BE.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Kjo iniciativë ligjore është në përputhje me objektivat e qeverisë dhe mbështet pikërisht objektivat e përcaktuar në Planin Kombëtar të Integritimit Evropian 2019-2021, kapitulli 24, “Drejtësia, liria dhe siguria”.

Ky projektligj është pjesë e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve, miratuar për vitin 2019 me vendimin nr.37, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Sanksionet ndërkombëtare (masat shtrënguese ndërkombëtare) janë një instrument kompleks i politikës së jashtme. Në vendosjen e sanksioneve ndërkombëtare është i detyrueshëm respektimi i parimit të sundimit të ligji, mbrojtjes të të drejtave të njeriut dhe synohet që aktorët politikë të rishikojnë kursin e tyre të veprimit.

Sanksionet janë efektive në momentin që zbatohen nga të gjitha shtetet. Sipas së drejtës ndërkombëtare (Karta e OKB-së), çdo sanksion i vendosur nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara (KSOKB) është ligjërish i detyrueshëm për të gjitha shtetet, të cilat duhet të marrin masa të menjëhershme për zbatimin e tyre (në të kundërt KS merr masa përkatëse ndaj subjekteve që nuk i zbatojnë ato).

Një tjetër organizatë ndërkombëtare, e cila ka të drejtë të vendosë sanksione në mënyrë të pavarur ose të zgjerojë masat ekzistuese të sanksioneve të vendosura nga OKB është edhe BE-ja. Sanksionet e vendosura nga BE-ja janë ligjërish të detyrueshme për vendet anëtare dhe zbatohen rregullisht nga aktet legislative po të BE-së (vendimet e Këshillit). Këtyre sanksioneve mund t'u bashkohen edhe vende të tjera që kanë një marrëdhënie me BE-në, siç janë edhe vendet e rajonit tonë, të cilat janë në procese integruese.

Shqipëria zbaton sanksionet ndërkombëtare të vendosura nga KS-ja dhe masat shtrënguese të BE-së, të cilat ndiqen në përputhje me angazhimet e politikës së jashtme të Shqipërisë, që rrjedhin nga neni 8, i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, e 2006 (MSA).

Aktualisht, vendi ynë zbaton ato masa shtrënguese ndërkombëtare të ndërmarra në kuadër të rezolutave të KSOKB-së, natyra e të cilave lidhet me terrorizmin apo financimin e terrorizmit, bazuar në ligjin nr.157/2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”.

Megjithatë ka një boshllëk ligjor lidhur me masat shtrënguese që nuk lidhen me terrorizmin apo financimin e tij, por që kanë të bëjnë me financimin e armëve të shkatërrimit në masë dhe që lidhen me zbatimin e drejtpërdrejtë të rezolutave të dala në zbatim të kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara, për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, për shtetet anëtare të saj. Duke qenë se

natyra e sanksioneve ka ndryshuar që nga themelimi i OKB-së është mjaft e rëndësishme që shtetet të angazhohen për të pasur mekanizma ligjorë kombëtarë për zbatimin e sanksioneve.

Procedurat e zbatimit të masave shtrënguese, që nuk lidhen me terrorizmin, apo financimin e tij, nuk janë të përcaktuara me ligj apo në ligje specifike, gjithashtu edhe procedura e ankimit ndaj masave shtrënguese dhe listimit që mund t'i bëhet një personi juridik apo fizik për shkak të një mase shtrënguese, duke krijuar kështu një vakuum ligjor.

Me qëllim zbatimin nga Republika e Shqipërisë të masave shtrënguese ndërkombëtare të ndërmarra në kuadër të rezolutave të (KS)-së, natyra e të cilave nuk lidhet me terrorizmin apo financimin e terrorizmit, ka lindur nevoja e krijimit të një baze ligjore për zbatimin e tyre.

Përveç zbatimit të masave shtrënguese në zbatim të rezolutave të KSOKB-së, vendi ynë, në përputhje me MSA-në, duhet të krijojë edhe mekanizmat e zbatimit dhe të monitorimit të masave shtrënguese që vijnë nga BE-ja. Kuadri i brendshëm ligjor i Shqipërisë duhet të jetë në përputhje me rekomandimet e BE-së për të bërë të mundur edhe zbatimin e masave shtrënguese.

Hartimi i këtij projektligji lidhet drejtpërdrejt me ruajtjen e sigurisë dhe paqes në botë; zbatimin e detyrimeve që burojnë nga anëtarësimi i vendit tonë në organizata ndërkombëtare; zbatimin e efektshëm të masave shtrënguese ndërkombëtare me fokus parandalimin e përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë duke ngrirë fondet dhe pasuritë e subjekteve përkatëse si dhe, vendosjen e sanksioneve për subjektet që nuk i zbatojnë; përcaktimin në mënyrë të detajuar të llojeve të sanksioneve ndërkombëtare, procedurave dhe mekanizmave të vendosjes së këtyre sanksioneve, mekanizmave të zbatimit dhe të monitorimit të masave shtrënguese, procedurave dhe mekanizmave të ankimit ndaj sanksioneve, subjekteve ndaj të cilave do të vendosen masat shtrënguese ndërkombëtare.

Hartimi i një ligji specifik për zgjidhjen e kësaj problematike është parë si zgjidhje edhe nga eksperiencat e vendeve të rajonit dhe jo vetëm. Variantet e shqyrtuara janë ato të shteteve si: Kroacia, Serbia, Maqedonia, Kosova, Çekia, Estonia, Letonia etj.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Iniciativa ligjore për hartimin e projektligjit “Për zbatimin e masave shtrënguese ndërkombëtare” është në përputhje me nenet 5, 78, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës.

Kjo iniciativë është në përputhje, gjithashtu, edhe me detyrimin që Republika e Shqipërisë ka si vend anëtar i Kombeve të Bashkuara për zbatimin e rezolutave të OKB-së që janë në zbatim të kreut VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara, si dhe vjen në kuadër edhe të:

1. Rekomandimeve të Task - Forcës për Veprim Financiar (TFVF) që kanë rishikuar standardet ndërkombëtare sa i përket luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Konkretisht, rekomandimi 6 mbi “Sanksionet specifike financiare të lidhura me terrorizmin dhe financimin e tij” dhe rekomandimi 7 mbi “Sanksionet specifike financiare të lidhura me përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë”;
2. Gjetjeve të Komitetit MONEYVAL (organizëm monitorues i Këshillit të Evropës nën varësinë e Komitetit të Këshillit të Ministrave të Këshillit të Evropës);
3. Gjithashtu, si vend që aspirojmë anëtarësimin në BE, miratimi i një projektligji të tillë është një domosdoshmëri, pasi mundëson zbatimin e masave shtrënguese të BE-së, si një detyrim në vijim të politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë (CFSP).

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky ligj nuk synon të përafrohet me *acquis communautaire*.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Hartimi i një ligji specifik për vendosjen e masave shtrënguese ndërkombëtare, do të rregullojë procedurën e vendosjes, zbatimit dhe shfuqizimit të masave shtrënguese ndërkombëtare, ku përfshihen dhe çështje/fusha të tjera, që mbulojnë rezolutat e KSOKB-së dhe sanksionet autonome të BE-së.

Projektligji është strukturuar në tre kapituj, me 22 nene dhe çdo nen është hartuar dhe parashikon përmbushjen e detyrimit të nenit 1, i cili përcakton se vendosja dhe zbatimi i masave shtrënguese ndërkombëtare bëhet në funksion të ruajtjes së paqes dhe sigurisë, parandalimit të konflikteve ndërkombëtare, mbështetjes dhe forcimit të demokracisë, sundimit të ligjit, respektimit të të drejtave të njeriut, si dhe arritjen e objektivave të tjerë të sigurisë së përbashkët, në përputhje me rezolutat përkatëse të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, akteve të organizatave të tjera ndërkombëtare apo marrëveshjeve ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë.

Në kuptim të parashikimeve të neneve 2 dhe 3, ky projektligj do të rregullojë procedurën e vendosjes, zbatimit, ndryshimit dhe shfuqizimit të masave

shtrënguese ndërkombëtare. Këto masa zbatohen ndaj subjekteve për të cilat ekzistojnë dyshime të bazuara për përfshirje në çdo formë të cenimit të paqes, sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare, demokracisë, të drejtave të njeriut, të shpallur nga rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, aktet e organizatave të tjera ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është anëtare; akteve të Bashkimit Evropian, si dhe masa të vendosura nga Republika e Shqipërisë.

Në nenin 4 parashikohen përkufizime për termat që do të përdorën në këtë ligj, duke përcaktuar edhe kuptimin e tyre. Për përkufizimet e përdorura për termat asete, fonde apo masa shtrënguese financiare i jemi referuar rekomandimit 7 të TFVF-së.

Në nenin 5 janë përcaktuar llojet e masave shtrënguese, ku përfshihen: ndërprerja e marrëdhënieve diplomatike; masat shtrënguese financiare; ndërprerja e plotë ose e pjesshme e marrëdhënieve ekonomike, tregtare dhe financiare; ndërprerja e korrespondencës, lidhjeve postare, telegrafike, telekomunikacionit dhe lidhjeve të tjerave të komunikimit; ndalimi i transferimit, ndërmjetësimit, tregimit, transportit, transitimit të armëve dhe pajisjeve ushtarake, dhënies së asistencës teknike dhe financiare, në lidhje me armët dhe pajisjet ushtarake jashtë vendit; ndalimi i hyrjes dhe kalimit transit në territorin e Republikës së Shqipërisë të personave fizikë të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi për të huajt; bllokimi i përkohshëm i aseteve që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë; masa të tjera shtrënguese në përputhje me të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për Republikën e Shqipërisë.

Në nenin 6 përcaktohet procedura që do të ndiqet nga Republika e Shqipërisë për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare për rastet e masave të vendosura nga BE-ja apo organizata të tjera ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë. Ministri përgjegjës për punët e jashtme i propozon Këshillit të Ministrave masën shtrënguese ndërkombëtare dhe subjektin ndaj të cilit vendoset kjo masë. Ministri përgjegjës për punët e jashtme, para se të përcjellë propozimin pranë Këshillit të Ministrave, për rastet e masave shtrënguese të vendosura sipas këtij neni, thërret Komitetin e Masave Shtrënguese Ndërkombëtare.

Ndërkohë, për masat shtrënguese ndërkombëtare të shpallura me rezoluta nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së, në kushtet kur të gjitha rezolutat e OKB-së të dala në zbatim të kreut VII, të Kartës së Kombeve të Bashkuara, është parashikuar një dispozitë më vete në nenin 7, e cila rregullon zbatimin e menjëhershëm të tyre. Parashikimi për zbatimin e menjëhershëm është bërë duke marrë në konsideratë edhe rekomandimin 7 të TFVF-së, si dhe të ekspertit ligjor të zyrës së KiE-së në Tiranë. Në këto raste, ministria, me marrjen e njoftimit nga Misioni i Republikës së Shqipërisë në *New York*, njofton

menjëherë organet përgjegjëse për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese të shpallura nga Këshilli i Sigurimit. Këto organe, sipas fushave të tyre të përgjegjësisë, marrin menjëherë të gjitha masat për zbatimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese të shpallura nga Këshilli i Sigurimit, objekt i këtij ligji.

Në nenin 8 rregullohet procedura e bllokimit të përkohshëm, që lidhet me aplikimin e nenit 6, dhe që ka të bëjë me momentin nga vendosja e masës shtrënguese ndërkombëtare nga BE-ja, apo organizata të tjera ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë, deri në daljen e vendimit të Këshillit të Ministrave për vendosjen, zbatimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Organet përgjegjëse, organet publike si dhe çdo person në Republikën e Shqipërisë janë të detyruar që të zbatojnë menjëherë dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë, pa e kushtëzuar procesin me miratimin e akteve të mëtejshme nënligjore brenda vendit, bllokimin e përkohshëm të çdo veprimi, ndërmjetësimi, transaksioni, transferte, shërbimi financiar apo të tjera të lidhura, fonde dhe pasuri të tjera, nga marrja dijeni për vendosjen, zbatimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare sipas përcaktimeve të këtij ligji. Bllokimi i përkohshëm bëhet me vendim të organit përgjegjës dhe ka vlefshmëri për një periudhë jo më shumë se 30 ditë pune, duke filluar nga dita e parë pas nxjerrjes së urdhrit.

Në nenin 9 është parashikuar procedura që do të ndiqet për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare me karakter të brendshëm, ku përfshihen rastet kur shteti shqiptar, me iniciativën e tij, për raste të shkeljes së nenit 1 të këtij ligji, vendos marrjen e masave shtrënguese ndërkombëtare. Organet përgjegjëse, sapo konstatojnë ose kanë dyshime bazuar në të dhëna se po vihet në rrezik rendi kushtetues, siguria kombëtare e Republikës së Shqipërisë, i propozon menjëherë Komitetit vendosjen e masave shtrënguese ndërkombëtare. Propozimi do të përmbajë arsyet e hollësishme të propozimit, të dhënat e subjektit, masën shtrënguese që do të vendoset, si dhe çdo të dhënë tjetër të mundshme. Nëse ka arsye për të besuar se mund të ketë tjetërsim në çdo formë të fondeve dhe pasurive të tjera, organi përgjegjës propozon nxjerrjen e një urdhri bllokimi të përkohshëm.

Në nenin 10 parashikohet krijimi i Komitetit të Masave Shtrënguese Ndërkombëtare, struktura dhe funksionet e tij. Komiteti do të jetë struktura që i rekomandon ministrit për propozimin në Këshillin e Ministrave vendosjen, ndryshimin ose shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, duke përjashtuar masat që do të vendosen në kuadër të rezolutave të KSOKB-së. Krijimi dhe detyrat e Komitetit do të bëhen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 11 përcakton organet përgjegjëse, sipas fushave të tyre të përgjegjësisë, si dhe në vija të përgjithshme detyrat e tyre për zbatimin e masave shtrënguese ndërkombëtare.

Në nenin 12 rregullohet procedura e zbatimit të masave shtrënguese të karakterit financiar, e cila lidhet me bllokimin e aseteve dhe fondeve. Ky parashikim është bërë në përputhje me rekomandimin 7.5 të TFVF-së. Në zbatim të këtij neni, organi përgjegjës ka detyrimin të bllokojë pa vonesë dhe pa njoftim paraprak asetet e subjekteve ndaj të cilave është vendosur masa shtrënguese financiare. Administrimi i aseteve dhe fondeve të bllokuara do të bëhet në përputhje me aktet ligjore në fuqi nga organet përgjegjëse sipas fushës së tyre të përgjegjësisë. Sipas rezolutës 1718 (2006), dhe rezolutave të saj pasardhëse (përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë), të gjitha shtetet anëtare të OKB-së duhet të kenë autoritetet dhe aftësitë për të zbatuar masat për ngrirjen e aseteve dhe të sigurojnë se çfarëdo fondi ose pasuri të tjera dhe burime ekonomike të mos vihen në dispozicion ndaj këtyre personave dhe subjekteve të shpallur. Sipas rezolutës 1737 (2006) dhe rezolutave të saj pasardhëse (mbi Iranin), të gjitha shtetet anëtare të OKB-së duhet të kenë autoritetet dhe aftësitë për të zbatuar masat për ngrirjen e aseteve dhe të sigurojnë se çfarëdo fondi ose pasuri të tjera dhe burime ekonomike të mos vihen në dispozicion të këtyre personave dhe subjekteve të shpallura, si edhe ata që veprojnë në emër të tyre ose nën drejtimin e tyre apo ato në pronësi ose të kontrolluara nga ata.

Në nenin 13 parashikohen rastet e lejimit të përdorimit të aseteve të bllokuara. Do të jetë gjykata kompetente e cila mund të lejojë që asetet e bllokuara të lirohen ose të vihen në dispozicion, nëse vërtetohet se këto asete janë të domosdoshme për mbulimin e kostove themelore të jetesës, qirasë apo hipotekës së banesës, ilaçet dhe trajtimin mjekësor, taksat dhe sigurimet ose shpenzimet e shërbimeve publike; pagesën vetëm të tarifave për mirëmbajtjen e rregullt të aseteve të bllokuara; për shkak të shpenzimeve të jashtëzakonshme, të tilla si shpenzimet që lidhen me lindjen e fëmijës, vdekjen në familje ose një situatë të ngjashme.

Lidhur me të dhënat që do të krijohen nga zbatimi i këtij ligji, neni 14 parashikon jo vetëm përpunimin e tyre në përputhje me legjislacionin për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror dhe mbrojtjen e të dhënave personale, por edhe se cilat do të jenë strukturat dhe nga do të merren këto të dhëna. Mënyra e përpunimit të të dhënave përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 15 parashikon krijimin e Regjistrisë së të Dhënave, i cili do të mbahet nga ministria përgjegjëse për punët e jashtme dhe do të përmbajë të dhëna për subjektet ndaj të cilave vendosen/ndryshohen/shfuqizohen masat shtrënguese ndërkombëtare; subjektet që shkelin zbatimin e masave shtrënguese të vendosura sipas këtij ligji; të dhëna të tjera në zbatim të këtij ligji. Krijimi,

përmbajtja, rregullat e administrimit dhe funksionimit, përdorimit dhe aksesimit të Regjistrit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit.

Në kreun III, “Dispozita të fundit”, përfshihen nenet që rregullojnë publikimin e masave shtrënguese, të drejtën e informimit, ankimit, kundërvajtjet administrative të vendosura për shkelje të këtij ligji, si dhe dispozita që parashikon miratimin e akteve nënligjore.

Neni 16 parashikon detyrimin që ministria përgjegjëse për punët e jashtme ka për publikimin në faqen e saj zyrtare të rezolutave të Këshillit të Sigurimit dhe të vendimeve të Këshillit të Ministrave për vendosjen, ndryshimin ose shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare.

Neni 17 i njeh çdo subjekti të interesuar të drejtën e informimit për të dhënat që kanë lidhje me vendosjen, ndryshimin apo shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare në përputhje me legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit, ruajtjen e informacionit të klasifikuar dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 18 parashikon të drejtën e ankimit. Subjektet ndaj të cilave janë vendosur ose ndryshuar masa shtrënguese kanë të drejtë të ankohen në gjykatën kompetente brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga botimi në “Fletoren zyrtare”. Kjo dispozitë është e zbatueshme për subjektet për të cilat vendosen masa shtrënguese sipas nenit 9, të këtij ligji. Ndërsa për subjektet e vendosura nën sanksion nga KSOKB-ja, BE-ja apo organizata të tjera ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë, subjekti ka të drejtën e ankimit në gjykatën kompetente vetëm në rastin kur pretendon se është identifikuar gabimisht me subjektin e shpallur.

Neni 19 parashikon rastet e ndëshkimit të organeve përgjegjëse dhe subjekteve që kanë detyrimin të zbatojnë këtë ligj. Dënimet administrative, sipas këtij neni, vendosen nga titullari i çdo organi përgjegjës në përputhje me fushën e tyre të përgjegjësisë. Procedurat e shqyrtimit, ankimit dhe të ekzekutimit të vendimeve për kundërvajtjet administrative bëhen në përputhje me legjislacionin për kundërvajtjet administrative.

Në nenin 20 parashikon rastet e përjashtimit të kërkesës për kompensim kundër Republikës së Shqipërisë apo të organit përgjegjës për zbatimin e masave të parashikuara në këtë ligj për dëmin e shkaktuar nga vendosja e masave shtrënguese ndërkombëtare.

Neni 21 parashikon bazën ligjore për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Me zbatimin e këtij projektligji ngarkohen këto institucione: ministria përgjegjëse për punët e jashtme; ministria përgjegjëse për çështjet e financave dhe ekonomisë dhe strukturat e varësisë; ministria përgjegjëse për çështjet e drejtësisë dhe strukturat e varësisë; ministria përgjegjëse për çështjet e mbrojtjes dhe strukturat e varësisë; ministria përgjegjëse për çështjet e brendshme dhe strukturat e varësisë; ministria përgjegjëse për çështjet e bujqësisë dhe strukturat e varësisë; ministria përgjegjëse për çështjet e infrastrukturës dhe strukturat e varësisë; Banka Kombëtare e Republikës së Shqipërisë; Prokuroria e Përgjithshme; Shërbimi Informativ i Shtetit.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdhrin nr.26, datë 2.2.2018, të Kryeministrit. Në këtë grup pune kanë marrë pjesë përfaqësues nga këto institucione: Ministria e Financave dhe Ekonomisë; Ministria e Drejtësisë; Ministria e Mbrojtjes; Ministria e Brendshme; Avokatura e Shtetit; Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara; Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara; Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave; Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve; Drejtoria e Përgjithshme e Doganave; Banka Kombëtare e Republikës së Shqipërisë; Prokuroria e Përgjithshme; Shërbimi Informativ i Shtetit.

Ky grup pune i kryesuar nga zëvendësministri i Punëve të Jashtme, në procesin e hartimit të projektligjit është fokusuar në: përcaktimin e fushës së zbatimit, si dhe llojeve të masave shtrënguese; masat shtrënguese që mund të vendosë vetë shteti ynë në të ardhmen ndaj një shteti, personi juridik dhe fizik të huaj; struktura përgjegjëse që do të propozojë dhe të monitorojë zbatimin e masave shtrënguese; procedura për vendosjen e masave shtrënguese; procesi i regjistrimit në një regjistër apo sistem të sanksioneve; afatet lidhur me zbatimin e një mase shtrënguese; shpejtësia e reagimit të institucioneve në vendosjen e masave shtrënguese; masat ndëshkuese që do të aplikohen ndaj subjektit që i është vendosur një sanksion dhe nuk e ka zbatuar atë.

Ky projektligj, nisur nga natyra e tij, nuk i nënshtrohet procesit të konsultimit publik, pasi del jashtë fushës së zbatimit të ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, konkretisht nenit 4, shkronja “b”, të këtij ligji, duke qenë se projektakti i nënshtrohet një procesi vendimmarrjeje që lidhet me marrëdhëniet ndërkombëtare dhe marrëveshjet ndërkombëtare.

Për këtë iniciativë ligjore MEPJ ka përgatitur edhe raportin e vlerësimit, i cili i bashkëlidhet praktikës së projektligjit.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji për masat shtrënguese ndërkombëtare nuk është akt që krijon të ardhura, pasi ai lidhet me zbatimin e politikave të sigurisë dhe detyrimeve që Republika e Shqipërisë ka marrë në kuadër të anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare.

Ndërkohë zbatimi i projektligjit do të shoqërohet me disa kosto për elementet e paraqitura, si më poshtë:

1. Në kuadër të këtij projektligji, parashikohet krijimi i një pozicioni specialisti pranë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, që do të merret me ndjekjen e procedurës së ekzekutimit të sanksioneve dhe realizimin e raportimeve. Në terma bruto, do të rezultojë një pagë prej 52 000 lekë për një person.
2. Një tjetër element ka të bëjë me mbajtjen e një regjistri elektronik të sanksioneve ndërkombëtare, që do të realizohet nëpërmjet një sistemi IT-je, me kosto 1 mln lekë. Sistemi do të administrohet nga specialisti që do t'i shtohet strukturës së Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme. Ndërkohë, institucionet e tjera përgjegjëse për monitorimin e procesit të ekzekutimit të sanksioneve ndërkombëtare do të kenë akses të kufizuar, në varësi të fushës së përgjegjësisë dhe rolit specifik që do të ketë secila njësi në këtë proces.

Kostot financiare për elementet e sipërpërmendura lidhen me daljen e akteve nënligjore të parashikuara për t'u miratuar në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2019 dhe janë parashikuar në PBA 2020-2022.

KËSHILLI I MINISTRAVE